ROLI I MËSIMDHËNËSIT MENTOR NË FORMËSIMIN E IDENTITETIT PROFESIONAL

Valeria Kola, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Formimi i identitetit profesional te studentët praktikantë paraqet një sfidë para vetës ku rol të vecantë në formësimin e tij luan mësimsdhënësi mentor. Qëllimi i këtij studimi është të përqendrohet në rolin e mësimsdhënësit mentor në formimin e identitetit profesional të studentëve praktikantë. Identiteti profesional është një koncept i rëndësishëm në zhvillimin e karrierës së individëve, kuptimi dhe formimi i tij kanë ndikim të thellë në të ardhmen e tyre profesionale. Hulumtimi është realizuar me metodën cilësore (kualitative). Mostra e hulumtimit përbëhet nga 10 mësimsdhënës mentor dhe 10 studentë praktikantë (të vitit të fundit të studimeve) të Universitetit të Edukimit “Hasan Prishtina”. Instrumenti matës është intervista gjysmë e strukturuar, ku për analizën e të dhënave është përdorur metoda tematike për të identifikuar temat e përbashkëta dhe mënyrën se si mësimsdhënësit mentor ndikojnë në formimin e identitetit profesional të studentëve praktikantë. Rezultatet e këtij studimi tregojnë se mësimsdhënësit mentor kanë një rol të rëndësishëm në ndihmën e studentëve praktikantë në zhvillimin e identitetit profesional. Për më tepër, ndikimi i mësimsdhënësve mentorë në identitetin profesional të studentëve praktikantë varet nga aftësitë e tyre në komunikim dhe ndërveprim me studentët, si dhe nga struktura e programit mentorues. Përfundimet kryesore të këtij studimi përfshijnë rekomandime për përmirësimin e programit mentorues dhe për zhvillimin e aftësive të mësimsdhënësit mentor në komunikim dhe ndërveprim me studentët praktikantë.

Fjalët kyçe: mësimsdhënës mentor, student praktikantë, identiteti profesional.

PËRVOJA E MËSIMDHËNËSVE NË MENAXHIMIN E SITUATAVE ME NXËNËSA PROBLEMATIK

Arditë Cakiqi & Albina Beqiri, *Fakulteti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Profesioni i mësimdhënësit ka të bëjë me zhvillimin edukativo-arsimor të gjeneratave pasardhëse dhe si i tillë ka përgjegjësi për formimin e një edukate shembullore, dhe zhvillimin e njohurive akademike të nxënësve. Qëllimi i këtij studimi ka të bëjë me eksplorimin e gjerë të përvojave të mësimdhënësve në ballafaqimin e situatave me nxënës me sjellje problematike të cilat janë definuar si: ikja nga ora, zhurma në klasë, posedimi i narkotikëve dhe armëve të ftofta, gjuha fyese dhe dhuna fizike. Hulumtimi ka përdorur metodën kualitative, ku mbledhja e të dhënave është bërë me anë të intervistave të gjysmëstrukturuara me tetë mësimdhënës të shkollave fillore të mesme të ulëta që janë intervistuar në ambientet shkollore. Të gjeturat e hulumtimit tregojnë mveshjen e roleve të shumta të mësimdhënësve dhe motivimin që ata shprehin për kryerjen e profesionit të tyre. Rëndësi të madhe i kushtohet edhe ndërveprimet dhe afërsisë me nxënës, dhe kjo ka treguar se ka një rol të rëndësishëm në formimin e sjelljes ppozitive të nxënësve. Hulumtimi ka theksuar gjithashtu edhe rolin e drejtorisë dhe prindit në menaxhimin e sjelljeve problematike dhe rëndësia e psikologut shkollor për ballafaqimin me sjellje problematike. Si përfundim, hulumtimi ka eksploruar kapacitetet dhe barrierat në të cilat mësimdhënësit i kanë hasur përgjatë eksperiencave të tyre me menaxhimin e sjelljeve problematike. Hulumtimi thekson se për një ndryshim të sjelljes së nxënësve, është shumë e rëndësishme bashkëpunimi i prindërve me mësimdhënësin dhe prezencën e psikologëve shkollor në institucionet përkatëse.

Fjalët kyçe: Mësimdhënësit, Nxënësit problematik, Strategjitë ballafaquese, Drejtorja, Prindërit, Psikologu.

PËRVOJA E STUDENTËVE DJEM NË AKTIVITETET EKSTRA-KURRIKULARE

Diarta Metolli & Donarta Uka, *Fakulteti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Aktivitetet ekstra-kurrikulare janë mënyra më e dobishme për shfrytëzimin e kohës së lirë, në mënyrë të strukturuar gjatë adoleshencës. Përpos që koha shfrytëzohet dobishëm, të angazhuarit mbahen larg nga sjelljet delikente dhe dukuritë negative. Studimi ynë ka qëllim të ekzaminoj eksperiencën e studentëve djem, gjatë angazhimit në aktivitete ekstra-kurrikulare. Duke shfrytëzuar metodën kualitative, ne kemi intervistuar tetë djem student nga Kosova, ku kemi eksploruar detajisht eksperiencën e tyre. Nga ky eksplorim ne kemi gjetur se studentët më së shumti qasen në aktivitete ekstra-kurrikulare përmes lajmërimeve dhe iniciativave brenda shkollës. Motivi i tyre kryesorë është vetë-avancimi, plotësimi i zbrazëtive personale e profesionale dhe dëshira për të kontribuar në komunitet. Ne poashtu kemi identifikuar përparësitë e të marrurit pjesë në aktivitete jashtë shkollore ku këtu përfshihen: zhvillimi i shkathtësive, socializimi dhe ngritja në hierarkinë e roleve. Një vështirësi që e ka rezultuar nga ky hulumtim ka qenë ajo e menaxhimit të kohës. Këto rezultate tregojnë se si aktivitetet ekstra-kurrikulare ndihmojnë në zhvillimin psiko-social të adoleshentëve dhe avancimin profesional të pjesëmarrësve, duke i mbajtur larg dukurive negative.

Fjalët kyçe: Aktivitete ekstrakurrikulare, djemet, shkathtësitë, koha e lire, menaxhimi i kohës.

KOSOVA INTERNATIONAL
CONFERENCE ON EDUCATIONAL
RESEARCH

NDËRLIDHJA E VETË-EFIKASITETIT TË MËSIMDHËNËSIT ME PERFORMANCËN E PËRGJITHSHME TË KLASËS NË SHKOLLËN FILLORE

Albulenë Shaqiri & Blerina Çibukçiu, *Kopshti "Hare", Prishtinë & Kopshti "Fole", Prishtinë, Kosovë*

Vetë-efikasiteti i mësimitdhënësit është një aspekt kyç që ndikon në performancën e nxënësve gjatë procesit mësimor. Objektivi i këtij studimi ishte që të përcaktojë lidhjen e vetë-efikasitetit të mësimitdhënësit me performancën e përgjithshme të klasës në shkollat fillore në komunën e Vushtrisë. Metodologjia kuantitative u përdorë për mbledhjen e të dhënave. Metodologjia e këtij studimi përfshin dy hapa të rëndësishëm të cilët trajtojnë mënyrën se si u mbledhën dhe analizuan të dhënat. Mbledhja e të dhënave u bë përmes dy instrumente të ndryshme. Për të vlerësuar vetë-efikasitetin e mësimitdhënësve, u përdor pyetësori "Teacher Self-Efficacy Scale" nga Bandura (1997), i përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe, ndërsa për të vlerësuar performancën e mësimitdhënësve, u realizua vëzhgimi objektiv përmes instrumentit standardizuar "The Classroom Assessment Scoring System". Studimi u krye në katër shkolla fillore në Vushtrri, me 20 mësimitdhënës dhe klasat përkatëse të tyre të ciklit I deri V. Analiza e të dhënave u bë përmes programit SPSS, duke përfshirë analizën e korrelacionit dhe regresionit. Rezultatet treguan një ndërlidhje të forte signifikante $p < 0.001$ mes vetë-efikasitetit të mësimitdhënësve dhe performancës së përgjithshme të nxënësve në klasë. Ky studim kontribuon në kuptimin e rëndësishëm të vetë-efikasitetit të mësimitdhënësit për performancën e përgjithshme të klasës në kontekstin e shkollës fillore.

Fjalët kyçe: vetë-efikasitet, mësimitdhënës, performancë akademike e klasës, shkollë fillore.

FOKUSI NË ZHVILLIM TË KOMPETENCAVE: A MUND TË ORGANIZOHET LËNDË PA VLERËSIM TË STUDENTËVE?

Xhavit Rexhaj, Kolegji AAB, Kosovë

Sot jemi dëshmitarë që elementi kryesor, i cili përcakton në mënyrë thelbësore ndërveprimin në relacionin mësimdhënës – student, është nota, respektivisht vlerësimi i studentit nga ana e mësimdhënësit. Një kundrim i këtillë i notës dhe vlerësimit e ka ngarkuar tej mase këtë relacion dhe për pasojë, rregullisht, e ka zhvendosur procesin e zhvillimit dhe të ndërtimit të dijes, aftësive, e kompetencave të studentëve në plan të dytë. Në anën tjetër, nota është parë dhe vazhdon të shihet si burim pushteti dhe arbitër i ndërveprimit në relacionin student – mësimdhënës, duke u dhënë mësimdhënësve përparësi në komunikim, por edhe zotësi shpesh të paqena intelektuale, profesionale e shkencore. Gjatë semestrit dimëror 2023/2024 me studentët e nivelit mastër të gjuhës angleze të Kolegjit AAB kemi organizuar një kurs (Strategji të përvetësimit të gjuhëve të huaja) në të cilin vlerësimi i studentit nuk e ka determinuar edhe raportin e ndërveprimit mësimdhënës - student. Me fjalë të tjera, kemi organizuar një kurs në të cilin studentët kanë vendosur në fillim të kursit nëse do të vlerësohen me vetëvlerësim, me notë mesatare nga lëndët e tjera, apo në mënyrën tradicionale (duke zgjedhur nga disa forma të vlerësimit nga mësimdhënësi). Studentët me zgjedhje të lirë janë ndarë në dy grupe: grupi eksperimental – vlerësimi jotradicional dhe grupi kontrollues – vlerësimi tradicional. Të dyja grupet kanë vijuar të njëjtin kurs, të njëjtat përmbajtje dhe të njëjtat detyra, ka dalluar vetëm forma e vlerësimit. Studentët më të suksesshëm në fund të kursit kanë fituar të drejtën që t'i shtrohen një testi për certifikim si Këshilltar për përvetësimin e gjuhëve të huaja. Rezultatet në fund të hulumtimit kanë dalë të jenë shumë inkurajuese për mua si mësimdhënës: studentët janë shumë më objektiv në vetëvlerësim duke e refuzuar hipotezën fillestare të hulumtimit se ‘gjatë procesit të vetëvlerësimit studentët do të shpërblejnë vetën në mënyrë arbitrare’. Njëkohësisht, edhe grupi me notë mesatare nga lëndët e tjera të atij semestri i kanë kryer dhe tejkaluar të gjitha obligimet e kërkuara në silabusin e lëndës për formimin e notës. Në përfundim, gjetjet e këtij hulumtimi në veprim mund të shërbejnë për të inkurajuar mësimdhënësit e tjerë që të shmangim fokusin e tepruar në notë dhe të përqendrohen më shumë në zhvillimin e ndërtimin e kompetencave.

IMPLEMENTIMI I TEKNIKAVE TË DICIPLINËS POZITIVE NË PRAKTIKAT E EDUKATOREVE DREJT RRITJES SË EMPATISË TEK FËMIJËT

Ardiana Ajeti & Morea Shehu, Institucioni Parashkollor “Shkronjat”, Prishtinë, Kosovë

Ky prezantim eksploron zbatimin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve që synojnë nxitjen e empatisë, ndarjes së lodrave dhe sjelljes zëvendësuese të fëmijët brenda mjedisit të kopshtit. Duke njohur rolin vendimtar të zhvillimit social dhe emocional, veçanërisht në fëmijërinë e hershme, kërkimi ynë fokusohet në strategji praktike për të kultivuar këto tipare thelbësore. Pjesë kyçe konsiderohet instalimi i një mendësie të re e cila duhet të ndikoj në mënyrën se si e shohim edukimin në fëmijërinë e hershme dhe si e trajtojmë atë në përgjithësi duke tentuar që gjithnjë e më shumë të zëvendësohen teknikat e punës së edukimit tradicional me ato të diciplinës pozitive dhe gjithashtu lehtësimin e aplikimit të kurrikulës 0-6. Temat kryesore që do dalin nga prezantimi përfshijnë rëndësinë e modelimit të sjelljeve empatike nga edukatorët dhe kujdestarët, vlerën e krijimit të një mjedisi mbështetës dhe gjithëpërfshirës dhe rolin e strategjive të përforcimit pozitiv në nxitjen e ndryshimeve të sjelljes. Rezultatet këtij prezantimi janë intervenimet e pesë (5) fëmijëve të grupmoshës 0-3 vjeçare. Me anë të vetëraportimit të edukatoreve të klasës/kopshtit dhe të prindërve këto teknika tregojnë përmirësime në ndjeshmëri midis fëmijëve pjesëmarrës duke zgjeruar spektrin e sjelljeve pro sociale dhe një gatishmëri më të madhe për t'u përfshirë në lojëra bashkëpunuese.

Fjalët kyçe: fëmijë, empatia, ndarja e lodrave, sjellje.

ANALIZIMI I PROCESIT TË KALIMIT NGA DHOMA BURIMORE NË KLASË TË RREGULLT

Arlinda Hasani, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Shpërbërja e klasave të bashkangjitura në dhoma burimore është e paraparë me ligj në vitin 2014. Lidhur me këtë, që nga viti 2014 ka filluar mbyllja e klasave të bashkangjitura dhe hapja e dhomave burimore. Kështu, nxënësit me nevoja të veçanta janë pjesë e klasave të rregullta, por mbajnë edhe orë plotësuese sipas nevojës në dhoma burimore. Pra, kalojnë disa herë gjatë javës nga klasa e rregullt në dhoma burimore. Prandaj, objekt studimi në këtë hulumtim është analizimi i procesit të kalimit të nxënësve nga dhoma burimore në klasë të rregullta. Kështu, termi dhomë burimore i referohet klasave, në të cilat ofrohen shërbime mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshira në klasë të rregullta brenda shkollës. Duke përdorur qasjen cilësore dhe dizajnin studim rasti ky studim udhëhiqet nga këto pyetje: Cilat janë praktikatat aktuale të kalimit të nxënësve nga dhoma burimore në klasë të rregullta?, Cilat janë sfidat e kalimit të nxënësve nga dhoma burimore në klasë të rregullta? dhe Cilat janë parakushtet e një procesi të suksesshëm të kalimit të nxënësve nga dhoma burimore në klasë të rregullta? Mbledhja e të dhënave është bërë me intervista gjysmë të strukturuar. Intervistat janë realizuar me drejtorët e shkollave, prindërit, mësueset mbështetëse dhe psikologët e tri shkollave të përzgjedhura si model për shkollat e tjera me dhoma burimore funksionale. Për përzgjedhjen e shkollave si model është përdorur mostra e qëllimshme, ku janë përzgjedhur qëllimisht tri shkolla me dhoma burimore funksionale, si: Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ali Kelmendi”, “Musa Zajmi” dhe “Zekeria Rexha”. Pjesëmarrja në këtë studim ishte vullnetare. Në bazë të rezultateve kryesore arrijmë në përfundim se kalimi i nxënësve nga dhoma burimore në klasë të rregullta ndjek disa praktika, faktorë kryesor dhe parakushte për realizimin e këtij procesi, si: vlerësimi i nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta, mbështetja e të gjithë nxënësve, krijimi i një rrjeti të bashkëpunimit, sigurimi i infrastrukturës, trajnimi i mësimeve dhe i prindërve. Të dhënat e këtij hulumtimi kanë dëshmuar edhe për ndikimin pozitiv në performancën akademike dhe socializimin e nxënësve duke kontribuar edhe në fitimin e vetëbesimit dhe mësimin përmes modelimit.

Fjalët kyçe: Dhoma burimore, klasa të rregullta, model, proces i suksesshëm.

ZHVILLIMI PROFESIONAL ME BAZË NË SHKOLLË - NJË NGA FORMAT MË PRODUKTIVE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE NË SHËRBIM

Hajrije Devetaku, *Kolegji UBT, Prishtinë, Kosovë*

Praktikat e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve me bazë në shkollë vlerësohen si ndër praktikat më të mira përmes të cilave zhvillohen mësimdhënësit në kontinuitet. Këto praktika burojnë nga iniciativat e shkollës si dhe nga vetë mësimdhënësit, bazuar në përvojat, sfidat dhe në nevojat e mësimdhënësve për zhvillim, duke shfrytëzuar kapacitetet e brendshme të shkollës. Qëllimi i hulumtimit është pasqyrimi i praktikave të mira të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë dhe fuqizimi i formave të tilla të zhvillimit profesional në shkollat e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Metodologjia e hulumtimit është e kombinuar, janë zbatuar metodat sasiore dhe cilësore, përmes anketës me mësimdhënës të arsimit parauniversitar dhe përmes Fokus grupit me ekspertë të arsimit. Gjetjet e hulumtimit sjellin argumente se praktikat e zhvillimit profesional me bazë në shkollë janë më frytdhënëse, më të qëndrueshme si dhe bazohen në kërkesat dhe në nevojat e mësimdhënësve për zhvillim profesional. Gjithashtu, të dhënat e hulumtimit tregojnë se format e zhvillimit profesional ndërliken me rritjen e bashkëpunimit në mes të mësimdhënësve, fokusohen në ndarjen e përvojave, në metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në krijimin e materialeve mësimore për punën me nxënës, në trajtimin e temave dhe problemeve që ndërliken me procesin mësimor në nivel të shkollës, në planifikimin e aktiviteteve mësimore, në format e mësimdhënies kreative dhe atraktive, në dëshirat, kërkesat dhe nevojat e nxënësve, në vetëvlerësim dhe vetëreflektim. Mbi të gjitha, këto praktika ndikojnë në rritjen e performances së punës së mësimdhënësve dhe në rezultatet e arritshmërisë së nxënësve, në krijimin e kulturës së shkollës dhe të mësimdhënësve për vetëzhvillim, në lehtësimin e procesit mësimor, eliminimin e problemeve dhe vëshirësive, duke e bërë shkollën një vend më të dashur dhe më miqësor për nxënësit dhe komunitetin e shkollës.

Fjalët kyçe: zhvillim profesional, vetëzhvillim, qasje kreative, qasje hulumtuese, bashkëpunim.

PERCEPTIMET E MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE PËR APLIKIMIN E MËSIMDHËNIES SË DIFERENCUAR NË SHKOLLAT FILLORE NË KOSOVË

Dijellza Hasani, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Mësimdhënia e diferencuar është një aspekt shumë i rëndësishëm i mësimdhënies i cili mund të quhet edhe "çelësi" i arritjes së të gjithë nxënësve. Bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, mësimdhënia e diferencuar nënkupton krijimin e programeve dhe materialeve të shumëfishta ashtu që nxënësit me aftësi, interesa apo nevoja të ndryshme mësimore të përjetojnë në mënyrë të barabartë rrugët e duhura për të absorbuar, përdorur, zhvilluar dhe prezantuar konceptet si pjesë e procesit mësimor të përditshëm. Studimi ka dy qëllime kryesore. Qëllimi i parë është të shqyrtojmë perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur mënyrën e aplikimit të mësimdhënies së diferencuar në klasë dhe qëllimi i dytë është të njihemi nga afër me strategjitë dhe teknikat mësimore që mësimdhënësit i përdorin në individualizimin e mësimit dhe sa ata kanë nevojë për formimin e tyre profesional në këtë aspekt të mësimdhënies. Hulumtimi u realizua në shkollat e komunës së Prishtinës, përkatësisht në klasat e pesta në dy shkolla publike dhe në dy shkolla private. Metoda e hulumtimit është sasiore. Për mbledhjen e të dhënave u përdorën dy lloje të pyetësorëve. Pyetësi për mësimdhënës i cili u realizua me N=9 mësues/e, të shkollave publike dhe N=9 mësues/e të shkollave private. Si dhe pyetësi për nxënës, i cili u realizua me N=20 nxënës të shkollave publike dhe N=20 nxënës të shkollave private. Rezultatet nxorën në pah fillimisht mungesën e njohurive të disa mësimdhënësve lidhur me nocionin "mësimdhënie e diferencuar", por megjithatë ata përdornin disa strategji për aplikimin e mësimit të diferencuar brenda klasave të tyre dhe u cilësuan si mjaft efektive dhe rezultatdhënëse. U pa që nevoja për përgatitje profesionale të mësimdhënësve në këtë aspekt është shumë e madhe dhe e domosdoshme. Kurse perceptimet e nxënësve treguan që në procesin mësimor të përditshëm ata punonin në forma të ndryshme dhe se nuk e pëlqenin shumë punën individuale si njëra nga format më të shpeshta të zbatimit të mësimdhënies së diferencuar.

Fjalët kyçe: mësimdhënie e diferencuar, individualizim, zbatim.

ANALIZË E SHTRIMIT TË PROBLEMEVE MATEMATIKORE NGA MËSIMDHËNËSIT PARA SHËRBIMIT PËR NXËNËSIT E NIVELIT FILLOR

Arsa Pruthi, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Shtrimi i problemeve dhe zgjidhja e problemeve janë shkathtësi të ndërlidhura mes vete dhe luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e të kuptuarit konceptual në matematikë. Meqë, mësimitdhënësit para shërbimit luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e këtyre shkathtësive të nxënësit, duke filluar që në edukimin fillor, është shumë e rëndësishme që ata vetë të jenë të përgatitur dhe të zotërojnë shkathtësitë për shtrimin dhe zgjidhjen e problemeve në matematikë.

Ky hulumtim përshkruet jo-eksperimental me qasje cilësore ka për qëllim shqyrtimin e shkathtësive të mësimitdhënësve para shërbimit për të shtruar probleme matematikore qoftë në situatën e lirë, të gjysmë-strukturuar apo situatën e lirë në të cilën përcaktohet ambienti i një parku lojërash ku hipotetizohet do të zhvillohet problemi matematikor.

Në këtë hulumtim përfshihen 82 mësimitdhënës para shërbimit, studentë të vitit të fundit të nivelit bachelor të Fakultetit Të Edukimit pranë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Përmes zhvillimit të një pyetësori u mblodhën gjithsej 233 probleme të shtruara dhe 164 përgjigje nga pyetjet e hapura.

Rezultatet e studimit tregojnë që mësimitdhënësit para shërbimit zotërojnë shkathtësi të shkëlqyeshme në formulimin problemeve matematikore në aspektin e qartësisë së tekstit, përputhjes me parimet matematikore dhe hartimit të problemeve gjysmë-reale. Ndërkaq, aspektet në të cilat ka hapësirë për përmirësim janë shkathtësitë e shtrimit të problemeve që kanë më shumë se një zgjidhje, që i takojnë kontekstit real, apo që janë probleme hetimore. Mësimitdhënësit para shërbimit i kushtojnë vëmendje qartësisë së tekstit, kontekstit nga jeta e përditshme dhe njohuritë paraprake të nxënësve. Një tjetër përfundim i rëndësishëm është se ambienti që mësimitdhënësit supozojnë të zhvillojnë një problem matematikor ndikon në karakteristikat e problemit matematikor. Gjetjet e studimit kontribuojnë në të kuptuarit e zotërimit të shkathtësive të mësimitdhënësve para shërbimit në shtrimin e problemeve, që mund të përdoren si bazë për zhvillimin e hulumtimeve në vijim apo për të përmirësuar strategjitë pedagogjike që rrisin shkathtësitë në shtrimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Fjalët kyçe: Shtrimi i problemit, zgjidhja e problemit, shkathtësitë e mësimitdhënësve.

QËNDRIMET E MËSUESVE TË NIVELIT FILLOR I-V PËR INTEGRIMIN NDËRDISIPLINOR TË TEKNOLOGJISË NË PUNËN E TYRE ME NXËNËS GJATË PROCESIT MËSIMOR

Sebahate Sopjani & Arbresha Beka, *Shfmu "Daut Bogujevci" & Shfmu "Naim Frasheri"*

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ndihmon mësuesit në kërkesat globale për të zëvendësuar metodat tradicionale të mësimdhënies me metoda të reja dhe të përditësuara. Në vendin tonë TIK-u konsiderohet si një nga elementët kryesorë në transformimin e vendit drejt zhvillimit të ardhshëm. Në KKK, arsimit në Kosovë u ofron studentëve kushte për zhvillimin maksimal të potencialit të tyre dhe përdorimin efektiv të teknologjisë gjatë mësimin të tyre. Në këtë kontekst, ky dokument vë në dukje rëndësinë e mësimdhënies dhe të nxënës bazuar në një nga qëllimet e arsimit, zhvillimin e sipërmarrjes dhe përdorimin e teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm. Ky hulumtim synon të identifikojë dhe përshkruajë qëndrimet e mësuesve të nivelit fillor 1-V në lidhje me integrimin ndërdisiplinor të teknologjisë gjatë punës së tyre në procesin mësimor. Metoda e hulumtimit e përdorur për këtë hulumtim është sasore. Pyetësorët për mësuesit e arsimit fillor të ciklit të ulët të të dy gjinive përdoren si instrumente kërkimore. Mostra për mësimdhënës gjatë anketës ishte e rastësishme dhe përfshinte të gjitha rajonet e Kosovës nga shkollat fillore publike, ato rurale dhe urbane. Anketa është për 300 mësues. Të dhënat e këtij hulumtimi sasior janë analizuar duke përdorur softuerin SPSS. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se integrimi i TIK-ut me lëndët e tjera është një vlerë e shtuar për mësuesit gjatë mësimdhënies dhe ofron një qasje të re në këtë proces, ku nxënësi zhvillon kompetencat e tij; Përgatitja e mirëpajisur e mësuesve me mjete dhe pajisje TIK është një nga faktorët kryesorë për suksesin e mësimdhënies dhe të nxënës të bazuar në teknologji dhe se programet e trajnimit të zhvillimit profesional për mësuesit luajnë një rol kyç në përmirësimin e të nxënës cilësor të nxënësve. Rekomandim: Për të adresuar perceptimet e mësuesve për integrimin e TIK-ut, është thelbësore të zbatohet një program zhvillimi profesional i synuar i përshtatur me nevojat e tyre specifike dhe niveleve të komfortit me teknologjinë, duke përdorur TIK-un në mënyrë të përshtatshme.

Fjalë kyçe: Integrimi i TIK-ut me lëndët e tjera; mësimdhënie dhe mësimnxënie; efektiviteti i teknologjisë; arsimimi.

META-ANALIZË: NDIKIMI I EDUKIMIT STEM NË ARRITJET NË MATEMATIKË DHE NË MOTIVIMIN E NXËNËSVE PËR DISIPLINAT STEM

Era Osmanaj & Eda Vula, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Edukimi STEM paraqet një qasje të re dhe inovative në fushën e edukimit që u ofron nxënësve mundësi për angazhim dhe të nxënësve ndërdisiplinor. Në një epokë ku edukimi STEM po merr vëmendje të shtuar, është e rëndësishme që hulumtuesit, specialistët e fushës arsimore dhe mësuesit të kuptojnë efektet e tij në arritjet akademike të nxënësve dhe motivimin e tyre. Kjo meta-analizë shqyrton pikërisht ndikimin e edukimit STEM në arritjet e nxënësve në matematikë dhe motivimin e tyre për disiplinat STEM bazuar në rezultatet e literaturës ekzistuese. Kriteret për përfshirjen e literaturës në meta-analizë ishin: të botuara ndërmjet viteve 2005-2024, të jenë hulumtime empirike që masin efektin e edukimit STEM në arritjet në matematikë apo për ndikimin në motivimin për disiplinat e STEM, mostër të jenë nxënës të shkollës së mesme të ulët dhe artikujt të jenë në gjuhën angleze. Pas procesit të kërkimit sistematik të literaturës nga gjithsej 434 artikuj, në bazë të kriterëve të përfshirjes dhe përjashtimit gjithsej u shqyrtuan 25 artikuj. Analiza e 15 artikujve për arritje me një total prej 28 madhësi efektsh rezultoi në madhësinë mesatare të efektit $g=0.440$ që tregon se edukimi STEM ka një ndikim pozitiv mesatar në arritjet e nxënësve në matematikë. Për variablen e motivimit nga 11 artikujt e shqyrtuar me një total prej 15 madhësi efektsh u gjetë madhësia mesatare efektsh $g=0.216$, rezultat që sugjeron se edukimi STEM ka një efekt të vogël pozitiv në motivimin e nxënësve për disiplinat STEM. Pas një analize të këtyre rezultateve, vlerësohet se edukimi STEM ka potencialin për të ndikuar pozitivisht në arritjet akademike për fushën e matematikës dhe motivimin e nxënësve për disiplinat e STEM. Në fund janë diskutuar disa kufizime dhe implikimet e studimit.

Fjalët kyçe: arritje, edukimi STEM, meta-analizë, motivim.

ROLI DHE PERCEPTIMET E MËSIMDHËNËSVE PËR PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË NË MËSIMIN E MATEMATIKËS

Dasara Sylejmani, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mund ta bëjë shkollën më efikase dhe produktive, duke krijuar kështu një shumëllojshmëri mjetesh për të rritur dhe lehtësuar aktivitetet profesionale të mësuesve. Teknologjia ndihmon nxenesit të zhvillojnë të gjitha llojet e aftësive nga më të thjeshtat tek më komplekset. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënien dhe mësimnxënien e matematikës. Për këtë qëllim, studimi synon të identifikojë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë në këtë kontekst, për të ofruar një perceptim të qartë mbi ndryshimet dhe tendencat në mësimin e matematikës duke përdorur teknologjinë. Gjithashtu, qëllimi është të sugjerojë praktika më efektive dhe udhëzime për përdorimin e suksesshëm të teknologjisë në mësimdhënie dhe mësimnxënien e matematikës në arsimin e sotëm. Metoda e hulumtimit është kuantitativ me dizajn të hulumtimit përshkrues dhe korrelativ. Instrumenti për mbledhjen e të dhënave është pyetësori për mësimdhënës. Pyetësori përmban pyetje të përqendruara në përvojën e mësuesve me përdorimin e teknologjisë, perceptimet e tyre mbi përfitimet dhe sfidat e kësaj praktike, si dhe pritjet e tyre për të ardhmen e përdorimit të teknologjisë në mësimin e matematikës. Pjesëmarrësit e këtij studimi janë mësimdhënësit e nivelit fillor nga komuna e Prishtinës, si komuna më e madhe në Kosovë. Mostra përfshin 150 mësimdhënës. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë analizuar përmes programit statistikor (SPSS). Rezultatet tregojnë se shumica e mësimdhënësve shohin teknologjinë si një mjet të rëndësishëm për të përmirësuar mësimin e matematikës. Ata vlerësojnë se teknologjia ofron mundësi të reja për të përfshirë dhe motivuar nxënësit, si dhe për të përmirësuar njohuritë e tyre në matematikë. Në anën tjetër, mësuesit raportojnë disa sfida dhe pengesa në përdorimin e teknologjisë në mësimin e matematikës. Këto mund të përfshijnë mungesën e trajnimeve të mjaftueshme për mësuesit, kufizimet buxhetore për të investuar në pajisje dhe software të nevojshëm, si dhe mosfunksionimin e pajisjeve teknologjike në mënyrë efektive.

Fjalët kyçe: Teknologjia, mësimi i matematikës, perceptimet e mësimdhënësve.

LIBRAT ‘ONLINE’ NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË TË NXËNIT NË SHKOLLAT FILLORE TË KOMUNËS SË TEARCËS

Teuta Ramadani-Rasimi, Donika Fejzuli, & Pranvera Iseni, *Universiteti i Tetovës & Shfk “Faik Konica”, Dobrosht, Maqedonia e Veriut*

Që nga fillimet e botimeve të librave, ata çdoherë janë botuar në mënyra të ndryshme. Me zhvillimin e teknologjisë librat e shtypur filluan që të botohen edhe në mënyrë elektronike. Reformat e reja në arsim, në shtator të vitit 2021, sollën një ndryshim të ri në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku nxënësit dhe shkollat iu referuan kësaj reforme për zhvillimin e mësimimit. Objektiva e hulumtimit tonë ishte të vlerësojmë dhe analizojmë perceptimet e nxënësve dhe drejtorave të shkollave për përfitimet dhe mangësit e reformës së re. Në këtë hulumtim morën pjesë 175 nxënës të klasave të V-ta të shkollave fillore të komunës së Tearcës, ku nëpërmjet pyetësorit arritëm në konkluzion se librat elektronik nuk janë shumë të përshtatshëm për nxënie. Edhe pse shumica e materialit mësimorë për nxënësit është i gatshëm në internet, ato përsëri preferojnë që të mësojnë me libra të shtypur. Gjithashtu, u intervistuan edhe pesë drejtor të shkollave fillore të të njejtave shkolla ku nëpërmjet përgjigjeve të dhëna paraqitën avantazhet e librave digjital duke treguar se teksti digjital i ndihmon nxënësit ta përvetësojnë materialin më shpejtë. Instruksionet e dhëna përmes teknologjisë e shkurtojnë kohën që i duhet nxënësit për të arritur objektivin e të mësuarit, kushton më pak, tekstet elektronike mund të përditësohen (bëhen update) me informacione të reja, gjithashtu ata paraqitën edhe disavantazhet e tyre kundrejt këtyre librave duke theksuarin seni rëndësia e kontaktit fizik dhe perceptimi i ndryshëm vizual që kanë nxënësit në librin e printuar, shfaq probleme shëndetësore si lodhja e syve, dhimbje koke dhe jo interes për hulumtime. Gjithashtu edhe shkollat duhen të kenë infrastrukturë më të zhvilluar për përdorimin e këtyre librave. Poashtu hipotezat e punimit tregojnë se librat digjital të vendosur në kontekstin e përmirësimit të procesit të të nxënit në shkollat fillore, kanë ndikim pozitiv, por edhe negativ në cilësinë e të mësuarit të nxënësit, pasi që librat janë mjet ndihmës që japin ngrohtësi dijesh, mbështetje në përgatitjen e nxënësve për një rregullim dhe funksionim shoqëror të suksesshëm në jetë.

Fjalët kyçe: reformat, nxënësit, drejtorët, librat ‘online’, Maqedonia e Veriut, Komuna e Tearcës.

PËRDORIMI I PLICKERS SI MJET PËR VLERËSIMIN FORMATIV NË LËNDËN E MATEMATIKËS

Edona Uka, *ShFMU "Daut Bogujevci", Fushë Kosovë, Kosovë*

Shfrytëzimi i teknologjisë mund të jetë një mbështetje e konsiderueshme në mësimdhënien dhe të nxëniet e matematikës, e në veçanti edhe i vlerësimit formativ. Ofrimi i informatës kthyesë të menjëhershme gjatë procesit të vlerësimit formativ, me qëllim të përmirësimit të performancës së nxënësve shpesh është vendimtar gjatë procesit të të nxëniet. Plickers janë karta që bazohen në përdorimin e teknologjisë. Kartat e tilla mundësojnë mbledhjen e të dhënave për punën e nxënësve në kohë reale. Kjo mënyrë e shpejtë e mbledhjes së të dhënave, respektivisht, përgjigjeve të nxënësve në klasë i ndihmon mësimdhënësit të kenë një pasqyrë të qartë për performancën e secilit nxënës gjatë procesit të të nxëniet të koncepteve matematikore apo gjatë zgjidhjes së detyrave. Pikërisht, ky studim shqyrton ndikimin e përdorimit të Plickers-ve si mjete të vlerësimit formativ në përmirësimin e njohurive matematikore të nxënësve dhe në zgjidhjen e saktë të detyrave. Metodologjia e këtij hulumtimi është hulumtim në veprim. Dizajni i hulumtimit është para dhe pas test me një grup të pjesëmarrësve. Hulumtimi është realizuar në ShFMU “Daut Bogujevci” në Fushë Kosovë kurse pjesëmarrës të hulumtimit ishin 39 nxënës të klasës së tretë, grupmosha 8-10 vjeç. Mbledhja e të dhënave është bërë me para-test/pas-test, pyetësor për nxënës dhe rubrikat e vlerësimit që janë përdorur gjatë procesit të të nxëniet. Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se përdorimi i Plickers si mjet i vlerësimit formativ mund të avancojë përmirësimin e të kuptuarit të koncepteve matematikore dhe arritjet e nxënësve në lëndën e matematikës. Po ashtu, përdorimi i Plickers-ve ndikoi në rritjen e përfshirjes së nxënësve në mësim dhe në vlerësimin e përparimit në mësim nga vet ata. Informatat kthyesë ishin të dobishme dhe nxënësit ishin më të sigurtë gjatë zgjidhjes së detyrave në matematikë.

Fjalët kyçe: Plickers, teknologjia, të nxëniet e matematikës, vlerësim formativ.

NEUROSHKENCA KOGNITIVE DHE INTEGRIMI TEKNOLOGJIK NË PROCESIN MËSIMOR: ANALIZA E RRJEDHSHMËRISË SË STILEVE TË NXËNIES DHE METODAVE TË MËSIMIT NË GJUHËN E DYTE PËRMES DETYRËS KOGNITIVE DHE EYE TRACKER-IT

Amantina Pervizaj Kelmendi, *Universiteti i Zagrebit, Zagreb*

Ky studim eksploron dinamikën komplekse të nxënies së gjuhës së dytë (SLA) nëpërmjet një perspektive neurokognitive. Hulumtimi synon të kuptojë ndërveprimin midis stileve të mësimi, metodologjive të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë si mjet për nxënie dhe vlerësim, bazuar në përvojën e ligjëruesve dhe studentëve shqiptarë të anglishtes. Për të arritur qëllimin, janë integruar një gamë metodash duke përfshirë intervista me ligjërues universitarë, teste të nivelit të njohurive në gjuhën e dytë dhe pyetësore të standardizuara. Gjithashtu, një detyrë kognitive (kompjuterike) është përdorur për të kuptuar kontekstin, ndërsa analiza neurokognitive është kryer duke monitoruar lëvizjet e syve përmes Eye Tracker-it. Gjetjet e studimit theksojnë ndikimin e rëndësishëm të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e nxënies së gjuhës së dytë, duke theksuar rëndësinë e bashkëveprimit të metodave dhe teknikave të mësimi në arritjen e objektivave të nxënies. Përveç kësaj, shenjat kontekstuale dalin si një faktor i rëndësishëm që ndihmon në përfshirjen dhe kuptimin e fjalëve. Ky studim kontribuon në fushën e SLA (dhe jo vetëm) duke ofruar implikime praktike për edukatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës për të optimizuar praktikat mësimore dhe për të promovuar strategjitë efektive të mësimi të gjuhëve, duke i lidhur hulumtimin neurokognitiv me qasjet pedagogjike. Ky studim ofron një kuptim holistik të proceseve në nxënie të gjuhës së dytë - SLA dhe hapësirë për zhvillime transformuese në fushën e arsimit.

Fjalë Kyçe: Hulumtim neurokognitiv, stilet e të nxënit, metodologjitë e mësimdhënies, integrimi i teknologjisë, Eye Tracker, detyrë kognitive.

HULUMTIM NË VEPRIM BASHKËPUNUES: NDIKIMI I PËRDORIMIT TË QASJES STEAM NË AFTËSITË E NXËNËSVE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE ME FJALË DHE PERVOJAT E TYRE EMOCIONALE

Laurita Terpeza & Adelina Kastrati-Beqa, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Ky studim ka qëllim të dyfishtë. Së pari studimi shqyrton efikasitetin e metodologjisë së hulumtimit në veprim bashkëpunues si një mjet për të përmirësuar qasjen e integruar STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë) në shkollat fillore. Nëpërmjet një partneriteti gjatë mësimit praktik midis studentes, mësimdhënëses së klasës dhe mëmëdhënësit universitar, ky studim eksploron se si hulumtimi bashkëpunues lehtëson zhvillimin profesional, pasuron praktikat pedagogjike dhe përmirëson rezultatet e të nxënësve të nxënësve. Qëllimi i dytë i studimit është shqyrtimi i ndikimit të qasjes së integruar STEAM në përmirësimin e aftësive të nxënësve për zgjidhje të problemeve matematikore me fjalë dhe i gjendjes emocionale të nxënësve përgjatë punës së tyre në projektin STEAM. Hulumtimi u zhvillua me 24 nxënës të klasës së pestë të një shkolle urbane në Prishtinë. Metodologjia e hulumtimit përfshin cikle përsëritëse të planifikimit, veprimit, vëzhgimit dhe reflektimit, duke nxitur një qasje dinamike dhe pjesëmarrëse ndaj krijimit dhe zbatimit të njohurive. Duke u mbështetur në dizajnin quazi eksperimental, të dhënat janë mbledhur nga para e pas testi i njohurive me probleme nga matematika dhe para e pas testi emocional. Nga analiza e të dhënave u tregua se ka një përmirësim të rëndësishëm të arritjeve në matematikë, nga para testi në pas test si rezultat i realizimit të projektit STEAM. Poashtu, nga analiza e testit emocional që u realizua para, gjatë dhe pas realizimit të projektit, nga 63% e nxënësve që ndiheshin të pasigurtë dhe nga 14% prej tyre që ndiheshin të frikësuar në fillim të projektit, gjatë punës së tyre, 94% kanë deklaruar se projekti STEAM në përgjithësi ka qenë ngazëllyes dhe kanë filluar që idetë e tyre të bëhen më të qarta. Pas perfundimit të projektit, 99% e tyre kanë deklaruar se janë të kënaqur dhe të lumtur me punën e tyre. Në fund, në studim diskutohet për rëndësinë e shfrytëzimit të hulumtimit në veprim si mjet i zhvillimit profesional të mësimdhënësve para dhe pas shërbimit.

Fjalët kyçe: Hulumtim në veprim bashkëpunues, qasja e integruar STEAM, arritje në matematikë, gjendje emocionale.

NDIKIMI I KREATIVITETIT TË MËSIMDHËNËSVE NË MËSIMNXËNIEN E LËNDËS NJERIU DHE NATYRA NË SHKALLËN E DYTË TË KURRIKULËS

Ena Balaj, SHFMU “Faik Konica” Prishtinë, Kosovë

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës u mundëson nxënësve të mësojnë për botën rreth tyre. Në kuadër të kësaj fushe është lënda Njeriu dhe natyra, nga e cila përmes koncepteve të përgjithshme nxënësit njihen me dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe natyrës. Ndër të tjera, për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësit rol shumë të rëndësishëm ka edhe mënyra e bartjes së informatave nga mësimdhënësit. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë ndikimin e kreativitetit të mësimdhënësve në mësimnxënien cilësore të lëndës Njeriu dhe natyra të nxënësit në shkallën e dytë të Kurrikulës. Pyetja kryesore e hulumtimit është: A ndikon kreativiteti i mësimdhënësve në lëndën Njeriu dhe natyra në mësimnxënie më cilësore të kësaj lënde të nxënësit? Qasja e hulumtimit është cilësore dhe sasiore. Në studim përfshihen temat mësimore të lëndës Njeriu dhe natyra për shkallën e dytë të Kurrikulës. Mbledhja e të dhënave do të bëhet përmes anketës, e cila do të përmbajë pyetje të strukturuar dhe pyetje të hapura. Pjesëmarrës në hulumtim janë mësimdhënësit e klasave III, IV dhe V së bashku me nxënësit e tyre. Rezultatet e hulumtimit do të vënë në pah ndikimin e kreativitetit të mësimdhënësve në mësimnxënien cilësore të nxënësve në lëndën Njeriu dhe natyra, në të kuptuarit më të thellë të përmbajtjeve mësimore të kësaj lënde dhe në nxitjen e të menduarit kritik të nxënësve.

Fjalët kyçe: mësimdhënie, kreativitet, mësimnxënie cilësore, mendim kritik.

TË MËSUARIT E ADN-SË PËRMES QASJES STEAM

Liza Ahmeti, Aida Berisha, Ezamira Simnica, & Ylberina Zekolli, *Shkolla "Akademia Ora", Shkabaj, Prishtinë, SH.F.M.U "Zejnel Salihu"- Pomozotin, Fushë Kosovë, & SH.F.M.U "Mihal Grameno" - Fushë Kosovë, Kosovë*

Integrimi i arsimit STEAM në kontekstin arsimor sjell me vete potencialin për të ndikuar pozitivisht në aftësitë e nxënësve për të kuptuar, analizuar dhe aplikuar njohuritë e tyre, veçanërisht në fushën e biologjisë. Në këtë kontekst të mësimi, integrimi i arsimit STEAM paraqet një model të shkëlqyer të bashkëpunimit midis shkencës, teknologjisë, inxhinierisë, artit dhe matematikës për të thelluar kuptimin e strukturës së ADN-së dhe për të frymëzuar nxënësit drejt një qasjeje inovative në studimet biologjike. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e arsimit STEAM në përparimin e njohurive të nxënësve të klasave të V-ta në lidhje me ADN-në dhe të vlerësojë rëndësinë e edukimit STEAM në procesin e mësimi dhe mësimdhënies. Metoda e hulumtimit të përdorur në këtë studim është një dizajn kuazi-eksperimental, duke përfshirë nxënësit e klasave të V-ta të shkollës "Mihail Grameno" në Fushë Kosovë si subjekte të studimit. Popullsia e këtij studimi është nxënësit e klasave të V-ta, ndërsa për qëllime hulumtuese janë zgjedhur në mënyrë të qëllimshme nxënësit e klasës V/6 dhe V/3. Për të vlerësuar ndryshimin në njohuritë e nxënësve për ADN-në, u përdorën instrumente si paratesti dhe pastesti, të cilat u administruan para dhe pas ndërhyrjes STEAM në klasë. Nga analiza e rezultateve, duket se ka një ndryshim evident në rezultatet e paratestit dhe pastestit mes dy grupeve të studimit: grupi kontroll dhe grupi eksperimental. Mesatarja e rezultateve të paratestit për grupin kontroll është 6.53, ndërsa për pastestin është 11.03. Në anën tjetër, për grupin eksperimental, mesatarja e rezultateve të paratestit është 5.86, ndërsa për pastestin është 12.69. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se arsimit STEAM inkurajon pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe aftësinë e tyre për të ndërmarrë veprime në bazë të njohurive të tyre, duke ndihmuar në rritjen e vetëbesimit. Prandaj, është e rëndësishme që integrimi i STEAM-it të jetë pjesë e programit mësimor dhe të zhvillohen aktivitete të ndryshme që të nxisin interesin e nxënësve për ADN-në, ndërsa mësuesit duhet të përgatiten për të përballuar sfidat e arsimit të së ardhmes.

Fjalë kyçe: STEAM, ADN, inovacion, integrim, mësim.

QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE NDAJ VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS DHE NDËRLIDHJA ME ANAGAZHIMIN NË PUNË

Lekë Ukaj & Besmir Ponik, *ShFMU "Besim Nrecaj", Lutogllavë, Kosovë*

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë qëndrimet e mësimitdhënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë rreth vlerësimit të performancës dhe angazhimit të tyre në punë. Për më tej, hulumtimi ka për qëllim eksplorimin e marrëdhënies mes qëndrimeve ndaj vlerësimit të performancës dhe angazhimit në punë të mësimitdhënësve. Gjithashtu, studimi do të eksplorojë dallimet sipas gjinisë, moshës, nivelit të edukimit, përvojës së punës së mësimitdhënësve në raport me qëndrimet e tyre ndaj vlerësimit të performancës. Për realizimin e punimit nga qasja kuantitative është përzgjedhur metoda përshkruese (descriptive) dhe e krahasimit të rastësishëm (casual comparison). Për ta realizuar hulumtimin janë përdorur 2 pyetësorë. Njëri pyetësor për matjen e qëndrimeve të mësimitdhënësve ndaj vlerësimit të performancës dhe pyetësori i dytë për matjen e angazhimit në punë. Pyetësorët janë të tipit Likert të matura me 5 shkallë, përmbajnë gjithsej 41 deklaratat. Pyetësorët priten të plotësohet nga mbi 300 mësimitdhënës të cilët japin mësim në shkollat, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, në vitin shkollor 2023-2024. Të dhënat e mbledhura do të analizohen me programin SPSS v.25 dhe programin AMOS. Për analizimin e të dhënave do të përdoren: Analiza përshkruese, Analiza Independent Samples Test, Analiza One-Way Analysis of Variance (ANOVA), Analiza Faktoriale Konfirmuese (CFA), Cronbach Alpha, Analiza e Korrelacionit. Të gjeturat do të tregojnë se çfarë janë qëndrimet e mësimitdhënësve ndaj vlerësimit të performancës së tyre dhe angazhimit në punë, si dallojnë këto qëndrime në raport me variablat demografike si dhe identifikimin e marrëdhënies mes këtyre dy koncepteve.

Fjalë kyçe: vlerësimi i performancës, angazhim në punë, mësimitdhënie.

PËRJETIMET E MËSIMDHËNËSVE FILLESTARË GJATË VITEVE TË PARA TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË MËSIMDHËNIES

Edona Vojvoda, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Faza e hyrjes në profesion shënon fillimin e karrierës për mësimdhënësit, e cila është një fazë tranzicioni nga përgatitja profesionale para shërbimit në praktikimin e profesionit në realitetin shkollor. Ky tranzicion karakterizohet me “tronditje nga realiteti” ku mësimdhënësit bëjnë implementimin e pritshmërive, vlerave dhe besimeve të formuara gjatë përgatitjes profesionale para shërbimit. Kjo fazë shoqërohet me sfida dhe përjetime që janë hap i rëndësishëm për krijimin e identitetit profesional në të ardhmen. Qëllimi i këtij hulumtimi është të eksplorojmë përjetimet e mësimdhënësve fillestarë gjatë viteve të para të ushtrimit të profesionit. Hulumtimi u realizua përmes qasjes cilësore fenomenologjike duke përfshirë 10 mësimdhënëse në shërbim, të nivelit fillor. Përmes intervistave gjysmë të strukturuar, pjesëmarrësit kanë shpalosur përjetimet gjatë viteve të para të hyrjes në profesion, duke reflektuar sfidat me të cilat janë ballafaquar, gjendjen emocionale dhe mënyrat si u kanë bërë ballë vështirësive me të cilat janë ndeshur në fillim të karrierës si mësimdhënëse. Të dhënat e mbledhura u analizuan përmes analizës tematike. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se faza e induksionit është sfiduese për mësimdhënësit. Pritshmëritë e krijuara në fazën para shërbimit kanë ndryshuar gjatë shërbimit në realitetin shkollor, duke theksuar një mungesë evidente të mbështetjes profesionale për mësimdhënësit fillestarë, e cila e rëndon dhe e përkeqëson gjendjen e tyre emocionale në atë periudhë. Megjithatë, gjetjet tregojnë se me kalimin e kohës, mësimdhënësit krijojnë ekuilibër emocional, si rezultat i reziliencës së krijuar me përvojë. Përjetimet negative lidhen kryesisht me raportet e mësimdhënësit fillestar me akterët e tjerë të komunitetit të shkollës, duke reflektuar mungesë të kulturës së bashkëpunimit në shkollë. Të dhënat e dala nga ky hulumtim kanë implikime të rëndësishme për të ndërmarrë masa drejt ndërtimit të strategjive konkrete dhe mekanizmave brenda shkollës, që ndihmojnë mësimdhënësit fillestarë të përshtaten me dinamikën e realitetit shkollor dhe të përmbushin detyrat e përgjegjësitë që vijnë me profesionin e mësimdhënies. Ndërhyrjet si ofrimi i mbështetjes brenda klasës, krijimi i programeve të mentorimit dhe zhvillimi i politikave që promovojnë kulturë bashkëpunuese brenda shkollës, mund të mbështesin në mënyrë efektive profesionalizmin e mësimdhënësve fillestarë në profesion.

Fjalët kyçe: mësimdhënëse fillestar, përjetime, profesion, zhvillim profesional.

MODELI I ÇERDHEVE ME BAZË NË KOMUNITET - NJË PARADIGMË EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE DHE REFORMAVE NË ARSIM

Arbenita Basha, *Institucioni Parashkollor "Shkronjat", Prishtinë, Kosovë*

Qëllimi i këtij prezentimi është të analizojë rolin dhe efektivitetin e modeleve të çerdheve me bazë në komunitet në procesin e implementimit të politikave dhe reformave arsimore. Metoda e këtij prezentimi është kuantitative dhe përfshinë një mostër prej 8 çerdheve me bazë në komunitet. Duke u përqëndruar në përfshirjen e fëmijëve dhe prindërve si dhe bashkëpunimin mes çerdheve, kërkimi identifikon praktikrat dhe strategjitë më të suksesshme të menaxhimit që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë dhe implementimit të politikave arsimore. Rezultatet e këtij prezentimi tregojnë një nivel të lartë të suksesit në përfshirjen e fëmijëve dhe prindërve në procesin edukativ nëpërmjet modeleve të çerdheve me bazë në komunitet. Përparësia e përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje dhe krijimin e një mjedisi përkrahës për fëmijët shprehet përmes një ndërveprimi efektiv midis prindërve, menaxhmentit, stafit edukativ dhe autoriteteve përkatëse të nivelit lokal. Roli i Komunitetit konsiston në sigurimin e objekteve dhe resurseve fillestare për çerdhet, subvencionimin e prindërve me të hyra të ulëta, ndërsa komuniteti udhëheq ato. Në përgjithësi, kjo analizë konfirmon se modeli i çerdheve me bazë në komunitet ofron një paradigmë efektive për edukimin e hershëm, duke ofruar mundësi komunitetit për përfshirjen e fëmijëve në edukim të hershëm dhe atë në lagjet e tyre, duke përfshirë prindërit në procesin e edukimit sikur edhe bashkëmenaxhimin e çerdheve, poashtu kontribuon në implementimin e politikave arsimore me kosto të lirë për institucionet financuese.

Fjalë kyçe: çerdhe me bazë në komunitet, përfshirje e fëmijëve në edukimin e hershëm, përfshirje e prindërve në vendimmarrje, politika arsimore.

ZBATIMI I SUKSESSHËM I QASJEVE INOVATIVE NË KLASË DHE MENAXHIMIT EFEKTIV INSTITUCIONAL

Lavdiqe Krasniqi-Mustafa, " *Shmu 2* " *Vushtrri, Kosovë*

Arsimi është thelbi i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, ndaj është thelbësore të hulumtohet zbatimi i qasjeve inovative dhe menaxhimi efektiv në këtë fushë. Kosova vitet e fundit, ka shfaqur një rritje të rëndësishme të investimeve dhe zhvillimit në fushën e teknologjisë ,duke e konsideruar atë si një nga motorët kryesorë të përparimit shoqëror dhe ekonomik. Ky studim synon të analizojë zbatimin e qasjeve inovative në nivel shkolle dhe menaxhimin efektiv institucional, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe përmbushjes së qëllimeve të politikave arsimore. Përmes kërkimit tonë, synojmë të ofrojmë një kontribut në kuptimin dhe përdorimin e praktikave të mira në arsim, duke nxitur një përmirësim të sistemit arsimor në tërësi. Gjetjet kryesore vëmendojnë lidhjene e ngushtë midis përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe zhvillimit të kurrikulës së re me rezultate pozitive për nxënësit dhe për institucionet arsimore. Do të përdorim metodën kërkimore analitike për të shqyrtuar ndikimin e qasjeve inovative në arsim. Metodologjia e këtij studimi do të jetë kualitative, përfshirë hulumtime të thella. Instrumenti kryesor do jetë kombinimi i intervistave, anketave, analizës së dokumenteve për të identifikuar ndikimin e qasjeve innovative për vlerësuar efektivitetin e menaxhimit institucional. Zbatimi i kurrikulës së re është një aspekt thelbësor i transformimit arsimor, duke siguruar që përmbajtja dhe metodologjitë e mësimi të përputhen me nevojat e shoqërisë moderne. Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie ofron mundësi për të përmirësuar angazhimin dhe mësimin personalizuar për çdo nxënë. Ndërkohë udhëheqja e institucioneve arsimore luan një rol kyç në drejtimin e strategjive dhe politikave që ndikojnë në zhvillimin e arsimit. Ndryshimet në politikat arsimore janë të nevojshme për të adresuar sfidat dhe mundësitë e kohës së sotme. Duke përdorur një qasje inovative dhe duke zbatuar një menaxhim efektiv, institucionet arsimore mund të përmirësojnë cilësinë e arsimit dhe të përshtaten me sfidat e ndryshimeve të shoqërisë dhe teknologjisë. Arsyetimi i këtij studimi është të përcaktojmë dhe të përmbledhim ndikimin e qasjeve inovative në arsim dhe menaxhimin efektiv institucional për të arritur qëllimet e politikave arsimore. Duke shqyrtuar praktikat aktuale dhe gjetjet e studimeve të mëparshme, synojmë të identifikojmë sfidat dhe mundësitë për përmirësim në fushën e edukimit. Në të njëjtën kohë, synojmë të ofrojmë rekomandime konkrete për praktikat më të mira dhe strategjitë e menaxhimit të arsimit për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e sistemit arsimor.

Fjalët kyçe: inovacion, teknologji, udhëheqje, politika

ANALIZA E NEVOJAVE TË MËSIMDHËNËSVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL NGA PRESPEKTIVA E DREJTORËVE TË SHKOLLAVE

Addhe Krasniqi & Majlinda Gjellaj, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Zhvillimi profesional i dedikohet përmirësimit të punës praktike të mësimit dhe ngritjes së cilësisë. Përgatitja e duhur dhe profesionalizmi i mësimit dhe dëshmohet në të arriturat apo performancën e nxënësve. Prandaj, mësimit duhet të jenë në hap me zhvillimet, ndryshimet dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi dhe identifikimi i nevojave të punonjësve arsimor për zhvillim profesional nga pikëpamja e drejtorit të shkollës. Për kryerjen e këtij studimi është përdorur metoda e cilësore hulumtuese, ku përmes analizës tematike kanë derivuar 5 tema të cilat lidhen me qëllimin e hulumtimit. Hulumtimi është realizuar përmes intervistimit të gjashtë drejtorëve të SHFMU dhe SHML të komunës së Pejës. Gjatë analizës udhëheqësit e shkollave fillimisht kanë përshkruar rendësin e zhvillimit profesional për të vazhduar me mënyren e identifikimit të nevojave për ZHPM nga ana e tyre, pastaj mënyren e inkurajimit/motivimit të mësimit për ndjekjen e programeve të ZHPM-së, skemen e organizimit të trajnimeve si dhe në fund sfidat e realizimit dhe implementimit të trajnimeve sipas përceptimeve të tyre.

Rezultatet tregojnë se drejtorët e shkollave ZHPM e shohin si komponenten kryesore që ndikon në përmirësimin e performancës së mësimit dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Të njëjtit pohojnë së krahas mësimit, drejtorët e shkollave janë akteret kryesor që i identifikojnë nevojat për ZHPM. Gjithashtu gjetjet tregojnë se drejtorët përdorin strategji të ndryshme për të inkurajuar këtë angazhim. Mirëpo krahas kësaj të njëjtit ballafaqohen me sfida të ndryshme siç janë jogatishmëria e mësimit për të marrë pjesë në programe të ndryshme të zhvillimit profesional, jofunkionimi i sistemit të licencimit të mësimit etj.

Ky studim ka nxjerr rekomandime me rëndësi shumëdimensionale, të cilat kanë impakt direkt në identifikimin e nevojave autentike që shërbejnë në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës. Poashtu, këto rekomandime do të shërbejnë si pikënisje e orientimit të politikave komunale/shtetërore për përmbushjen e kërkesave të mësimit për zhvillim profesional.

Fjalët kyçe: Identifikim i nevojave, institucionet arsimore, mësimit, ngritje e cilësisë, zhvillim profesional.

STRUKTURA E RREGULLIMIT TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE NË POLITIKAT ARSIMORE

Fitore Thaqi & Alba Morina, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë gjatë dekadës së fundit ka përjetuar një ndryshim të rëndësishëm, të ngjashëm me zhvillimet e vendeve ndërkombëtare. Ky ndryshim paraqet një kthesë, duke e vendosur nxënësin në qendër të procesit mësimor, ndryshe nga mësimdhënia e mëparshme ku mësimdhënësi ishte në qendër. Institucionet arsimore janë të angazhuara vazhdimisht duke punuar për të avancuar dhe rritur cilësinë e punës praktike të mësimdhënësve. Pikënisje e suksesshme do të ishte zhvillimi profesional i mësimdhënësve si një mekanizëm me anë të të cilit synohet përmirësim, arritje e cilësisë arsimore dhe licencim i mësimdhënësve.

Qëllimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve është që të ofrojë mundësi përparimi në praktikat profesionale e pedagogjike në ambientin shkollor. Kjo ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe për të përmbushur kërkesat e sistemit për licencim të mësimdhënësve. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga pesë fushat kyçe të performancës së shkollës, përcaktuar nga Korniza e Sigurimit të Cilësisë për Performancës së Shkollës (MASHTI & IPK, 2016).

Qëllimi i hulumtimit është të paraqesë mënyrën e rregullimit të Zhvillimit profesional të mësimdhënësve sipas politikave arsimore vendore dhe ndërkombëtare si një mekanizëm i brendshëm që mund të ketë ndikim në ngritjen e cilësisë arsimore. Ngaqë, hartimi dhe zbatimi i politikave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve sikurse në Holandë, Singapor, Suedi, Australi e ShBA tregon një proces të suksesshëm duke vendosur standarde rreth kohëzgjatjes dhe temave për format e trajnimeve profesionale.

Metodat e përdorur në hulumtim përfshijnë analizën teorike të dokumenteve që rregullojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Dizjani i hulumtimit është meta-analizë, saktësisht dokumentet që përfshijnë Udhëzimet administrative, Udhëzuesin për zbatim të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, artikuj etj.

Hulumtimi tregon që akterët e komunitetit shkollor dhe nivelet menaxhuese ndihmojnë në avancimin e aftësive dhe shkathtësive të mësimdhënësve për një hap drejt zhvillimit të aftësive dhe shkathtësive praktike e kurrikulare. Bashkëpunimi me shkollat e tjera, ndarja e aktiviteteve dhe programeve, si dhe mbështetja nga institucionet e arsimit është burim thelbësor për suksesin e mësimdhënësve në zhvillimin, avancimin dhe licencimin në profesion/karrierë.

Fjalët kyçe: mësimdhënësit, zhvillimi profesional, institucioni shkollë, politikat arsimore.

POSTER PRESENTATIONS

PEDAGOGICAL STRATEGIES USED IN ENGLISH CLASSES TO IMPROVE STUDENTS' SELF-CONFIDENCE

Hamide Begaj

Development of self-confidence in students is crucial for effective language acquisition, particularly in English language classes. This research paper explores pedagogical strategies that enhance students' self-confidence, thereby improving their participation and proficiency in English. Through an extensive literature review, the study examines various teaching approaches, such as collaborative learning, positive reinforcement, the use of authentic materials, and technology integration. Findings highlight that interactive and student-centered strategies significantly boost self-confidence across different stages of language learning—beginner, intermediate, and advanced. Additionally, the paper discusses the theoretical frameworks underpinning self-confidence in educational psychology, including Bandura's self-efficacy and Krashen's affective filter hypothesis. Students' perceptions of these strategies are generally positive, with a preference for methods that lower anxiety and promote active engagement, such as self-recorded videos and peer collaboration. The research confirms that fostering a supportive and engaging learning environment is essential for enhancing students' self-confidence and, consequently, their language proficiency. While the study relies on secondary data, it provides valuable insights for educators and policymakers on effective pedagogical practices to empower English language learners.

Keywords: self-confidence, language acquisition, pedagogical strategies, English language teaching, educational psychology, collaborative learning

NDIKIMI I PUNËTORISË NË BINDJET E MËSIMDHËNËSVE PARA SHËRBIMIT PËR MËSIMDHËNËSIN HULUMTUES

Norë Cakiqi, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Një nga modelet që ndikojnë në ndryshimin e praktikave të mësimit në edukim dhe mësuesi është hulumtimi. Hulumtimi i përmirëson praktikën e edukimit dhe mësimit për të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor sepse siguron arsim sa më efektiv dhe ka për qëllim përmirësimin e dijes dhe aftësive të studentëve. Duke realizuar studime të veprimit, mësuesit mund të identifikojnë praktikën më të suksesshme dhe ato që nuk japin rezultate të dëshiruara. Kjo mund të përfshijë vlerësimin e efektivitetit të strategjive të mësimit në klasë dhe identifikimin e modelit më të mirë. Hulumtimi gjithashtu mund të përdoret për të ndarë njohuritë dhe praktikën me mësues të tjerë dhe të formojë një kulturë të mësimit së përbashkët në një shkollë ose në një komunitet të mësimit, por edhe më gjerë. Ndër të tjera, hulumtimi në veprim inkurajon mësuesit dhe praktikantët të eksperimentojnë me metoda të reja të mësimit dhe strategji për të përmirësuar efektivitetin e tyre. Kjo krijon një kulturë të inovative dhe ndihmon në gjetjen e mënyrave të reja dhe më të mira për të arritur qëllimet arsimore. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i ndikimit të punëtorisë në bindjet e mësimit para shërbimit për mësimit hulumtues. Metoda kërkimore që do të përdoret për realizimin e këtij hulumtimi është hulumtimi në veprim sepse përshtatet me qasjen dhe tematikën e hulumtimit. Nga ky hulumtim, mësuesit para shërbimit do të fitojnë njohuri më të thella rreth metodave të hulumtimit, si dhe rreth rëndësisë së hulumtimit në veprim për të përmirësuar praktikën e tyre mësimore. Mësuesit para shërbimit do të nxisen të reflektojnë mbi praktikën e ardhshme të mësimit dhe mbi rolin e tyre në procesin e hulumtimit. Kjo do të rrisë vetëdijen e tyre për impaktin e veprimeve të tyre të ardhshme mbi nxënësit. Mësuesit para shërbimit mund të ndryshojnë bindjet e tyre në lidhje me hulumtimin në veprim dhe rolin e tyre si mësues hulumtues. Kjo mund të ndikojë në mënyrën se si ata e shohin veten e tyre si agjentë të ndryshimit në procesin arsimor.

Fjalët kyçe: mësues hulumtues, mësues para shërbimit, bindje, etj.

NDARJA E LODRAVE NË BAZA GJINORE TEK FËMIJËT PARASHKOLLORË

Ardiana Ajeti & Morea Shehu, *Institucioni Parashkollor "Shkronjat", Prishtinë, Kosovë*

Zhvillimi i skemave gjinore tek fëmijët fillon që në moshë të re, i ndikuar nga normat shoqërore dhe ndërveprimet e edukatoreve/kujdestarëve. Ndikimi i medias, përforcimi verbal i stereotipeve dhe ndarja e lodrave në dyqane, nxjerrin në pah natyrën e shumëanshme të socializimit gjinor në fëmijërinë e hershme. Kjo kontribuon në të kuptuarit tonë të formimit të hershëm të identiteteve gjinore dhe nënvizon rëndësinë e krijimit të mjediseve mbështetëse që lejojnë fëmijët të eksplorojnë një gamë të gjerë interesash, pavarësisht nga stereotipet gjinore. Ky studim eksploron shfaqjen e preferencave gjinore në mesin e 20 parashkollorëve në Prishtinë, të moshës 5 vjeç, përmes një studimi vëzhgues dyditor. Metodologjikisht, ky studim përdori vëzhgim të drejtpërdrejtë dhe vlerësime të bazuara në listë kontrolli për të dokumentuar preferencat dhe sjelljet e fëmijëve. Të dhënat e mbledhura ofrojnë njohuri të vlefshme për formimin e hershëm të skemave gjinore dhe ndikimin e tyre në zgjedhjet e fëmijëve. Vëzhgimet zbuluan një lidhje të qartë midis gjinisë dhe preferencës së ngjyrës dhe theksoi dallimet në lodrat e preferuara, ku nënvizohet rëndësia e të kuptuarit se si fëmijët i përvetësojnë stereotipet gjinore që në moshë të re, duke formuar preferencat dhe sjelljet e tyre. Adresimi i kufizimeve, si ndikimi i medias dhe përforcimi verbal i stereotipeve, është thelbësor për promovimin e barazisë gjinore dhe nxitjen e interesave dhe aftësive të ndryshme mes fëmijëve. Bazuar në gjetjet dhe kufizimet e identifikuara në këtë studim, mund të rekomandohen disa rrugë për kërkime të ardhshme për të çuar më tej të kuptuarit tonë të preferencave gjinore në zhvillimin e fëmijërisë së hershme: Studime gjatësore, krahasime ndërkulturore, qëndrimet dhe jelljet e prindërve dhe studime eksperimentale.

Fjalët kyçe: lojrat, bazat gjinore, fëmijët, ndarja e lodrave.

MJEDISI STIMULUES NË KLASË DHE PËRFSHIRJA E ELEMENTEVE TË TIJ NË KORNIZËN KURRIKULARE TË KOSOVËS

Fatjeta Ahmenti

Mjedisi stimulues në klasë ofron një ambient të përshtatshëm për nxënien dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve, duke inkurajuar kreativitetin dhe angazhimin e tyre. Krijimi i një mjedisi për të nxënë apo një mjedisi stimulues në klasë është një temë mjaft e rëndësishme dhe aktuale në fushën e arsimit. Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi i detajuar i përfshirjes së elementeve të mjedisit stimulues në Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe analizimi se si kjo përfshirje mund të përmirësohet për të pasur një ndikim më të madh në procesin e nxënies dhe mësimin. Metodologjia e përdorur në këtë studim ka karakter cilësor. Në këtë hulumtim është përdorur metoda cilësore e hulumtimit. Instrumenti i përdorur në këtë hulumtim është analiza e dokumenteve. Detajisht janë analizuar dokumentet e përzgjedhura, të cilat janë: Korniza Kurrikulare e Kosovës, Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat 0, I, II, III, IV, V) dhe Strategjia e Arsimit 2022-2026. Përmes analizës së këtyre dokumenteve, studimi kishte synim të zbulonte detaje, përpjekje dhe tendenca që lidhen me përfshirjen e elementeve të mjedisit stimulues në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, duke dhënë një pasqyrë të qartë të qasjes aktuale dhe të mundësive për përmirësim në këtë fushë. Në bazë të analizës së kryer, është evidentuar se pavarësisht përpjekjeve për të përfshirë në kompetencat, qëllimet dhe rezultatet, mjedisi stimulues nuk trajtohet si prioritet në Kornizën Kurrikulare të Kosovës. Gjetjet nga ky hulumtim theksojnë nevojën për një rishikim të thellë të qasjes ndaj krijimit e mjedisit për të nxënë dhe mjedisit stimulues në përgjithësi. Ky studim përmbledh një vështrim kritik të mënyrës se si është trajtuar mjedisi stimulues në dokumentet kryesore të arsimit në Kosovë. Nëse përdoren si bazë për diskutime dhe politika arsimore të arsimit, rezultatet e këtij studimi mund të ndihmojnë në avancimin e praktikave të mira dhe në përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë.

Fjalët kyçe: mjedisi stimulues, mjedisi për të nxënë, dokumente, kurrikula etj.

THE IMPACT OF REAL AND VIRTUAL EXPERIMENTS ON THE UNDERSTANDING OF ELECTROMAGNETIC INDUCTION

Almenda Gashi Terziu

In this research, we investigate the advantages and disadvantages of using real and virtual experiments in developing higher order thinking skills. The target group was 12th grade high school students (American System) conducted over a period of three years 2019/2022/2023. The students were divided into three groups (classes): Virtual group, Real group and Traditional group which were selected spontaneously. Real experiments were included in the classes of the Real group, virtual experiments were included in the classes of the Virtual group and traditional direct teaching was used in the Traditional group. The virtual experiments have possibility to make the invisible things visible, by using PHET Simulations. This feature influences the students understanding in a clear way. On this basis, the students in the Virtual group have better answers and explanations from the ones in the Real group. The students in the real group compensate the lack of visualization with use of formulas, which in many time leads them to an incorrect answer. On the other hand, the research reveals that the students from the Real group can apply the acquired knowledge better than the ones in the Virtual group. Traditional group have better understanding in the calculation part, but less in practical observation. However, the three methods are complementary in student's knowledge and skills.

Keywords: Electromagnetic induction, Virtual experiments, Real Experiments, American system,

12th grade students.

DIGITALIZATION REFORMS IN THE EDUCATION SYSTEM

Miranda Lushaj Shala, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Higher education and university education reform has been and remains one of the most important public topics in any country in the world. Education is one of the most important areas of any society and any system. Through education, societies and nations transmit to their members knowledge, culture, cultural heritage, values through which society moves forward. It is also one of the areas that not only affects society, but is also strongly influenced by it and social changes. The fact that education systems are in constant change does not indicate instability, on the contrary, they serve to adapt as best as possible to changing society. Education is a process that paves the way for the country's tomorrow and guarantees a better today. As such, education must take into account two basic principles: Education first, and education second. Both concepts are and should be well defined: education as a process of personality development, and education as a process of mental development of the subject. The administration reform in the education sector aims to consider scientific research as one of the important instruments of system management at the level of governing bodies and schools themselves. Today's technology creates thousands of opportunities to read, to choose and above all to shorten the reading time. In the global era, digitization has developed rapidly, and along with this development, there is a need to deepen the thinking about basic reforms in the field of education as well. The purpose of carrying out this study is to research the reforms of digitalism in education. In this paper, the mixed method was used, where from the obtained results it appears that digitization is one of the best ways towards the future and one of the best opportunities for scientific and educational achievements.

Keywords: education, education, digitalization, reform.

INTEGRATING TECHNOLOGY INTO INSTRUCTION AND FIFTH GRADE STUDENT ACHIEVEMENT

Djellza Geci, *Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Përfitimet nga integrimi i teknologjisë në mësimdhënienë janë theksuar në shumë artikuj shkencor. Edhe në politikat arsimore në Kosovë është paraparë integrimi i teknologjisë. Megjithatë, në shkollën ku ne punojmë, teknologjia përdoret shumë pak nga ana e mësimdhënësve ndërsa një ndër sfidat kryesore mbetet përmirësimi i arritjeve të nxënësve. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi në veprim është të kuptojmë se si ndikon integrimi i elementeve të caktuara të teknologjisë në njësinë e caktuar mësimore në arritjet e nxënësve të klasës së V-të të shkollës fillore. Hulumtimi do të realizohet përmes dizajnit sasior ndërsa do të përdoret metoda kuazi-eksperimentale. Do të shfrytëzohen dy grupe të pjesëmarrësve (katër klasa të V-ta) që punojnë me kurrikulë të njëjtë. Hulumtimi do të bëhet në shkollën “Hilmi Rakovica”- Prishtinë, ndërsa numri i pjesëmarrësve në grupin e parë është 47 ndërsa në grupin e dytë 47 nxënës. Në njërin nga këto grupe (eksperimental), njësia e paraparë me kurrikulë në lëndën “Njeriu dhe natyra” do të zhvillohet duke i integruar disa nga elementet e teknologjisë. Të dhënat do të mblidhen përmes vëzhgimeve dhe rezultateve numerike në pastestin që do të zhvillohet me të dy grupet. Paraprakisht, do të përgatitet fletëvëzhgimi me kode të caktuara si dhe do të përpilohet testi duke u bazuar në arritjet e pritura për njësinë e caktuar mësimore, sipas kurikulës. Kështu, përmes vëzhgimit synohet të kuptohet sjellja e nxënësve në raport me integrimin e elementeve të teknologjisë në mësimdhënienë ndërsa përmes rezultateve të pastestit do të analizohen dhe krahasohen arritjet e nxënësve për të mësuar se si ka ndikuar integrimi i këtyre elementeve të teknologjisë në suksesin apo dështimin e rezultateve të synuara nga mësimdhënësi. Ky hulumtim në veprim është planifikuar të zhvillohet gjatë javës së parë të muajit maj 2024.

Fjalët kyçe: *Teknologji, integrim, mësimdhënienë, nxënës.*

MENAXHIMI EFEKTIV I KLASËS SË SHEKULLIT XXI NË RASTIN E PUNËS PRAKTIKE TË MËSIMDHËNËSVE

Besjana Rexhepi, *Shfmu "Skender Emërllahu", Ramjan, Viti, Kosovë*

Në vazhden e sfidave që ka misioni i mësimdhënies në epokën e sotme të ashtuquajtur si “epokë moderne”, konsiderohet të jetë menaxhimi i klasave dhe orëve mësimore, prej nga prej të mësuarit tradicional, kemi kaluar në një proces bashkëkohor edukativo- arsimor. Në këtë drejtim padyshim se vetë menaxhimi i klasës është sfidë objektive për punën praktike për të gjithë mësuesit e shkollave të arsimit parauniversitar, kudo që punojnë. Rrjedhimisht ky lloj punimi fokusohet në eksperiencat praktike të mësimdhënësve të ciklit 1-5, lidhur me sfidat që ata i hasin në menaxhimin e klasave të tyre. Hulumtimi është i llojit cilësor dhe instrument hulumtimor është intervista e standardizuar, pjesë e së cilës janë këta respondentë: 10 mësimdhënës nga klasat: 1- 5 në dy paralelet e Shfmu “Skender Emërllahu” në Ramjan dhe Fshat i ri të Vitisë dhe 23 nxënës të klasave 4 dhe 5, nga po kjo shkollë. Intervista e mësimdhënësve përmban 15 pyetje dhe e nxënësve 7 pyetje. Hulumtimi ka për qëllim të identifikoj vështirësitë dhe format e menaxhimit të klasës dhe të orës mësimore që i kanë mësimdhënësit e kësaj shkolle, duke i krahasuar ato në mes tyre. Të dhënat e nxjerrura janë incizuar në audio fillimisht dhe më pastaj janë transkriptuar në Word dhe analizuar sipas metodës deskriptive dhe krahasuese, duke nxjerrur të dhëna të ndryshme sipas pyetjeve të intervistave. Punimi do t’i vë spikamë të veçantë prindërve dhe organeve gjegjëse edukativo-arsimore të kësaj shkolle dhe komune njashtu, se duhet pasur bashkëpunim edhe më cilësor e jo ndërhyrje negative në kategorinë e mësimdhënësve, në mënyrë që të arrihen rezultate edhe më të mira në procesin edukativo- arsimor, ashtu siç edhe pretendohet në mësimdhënien e shekullit XXI.

Fjalë kyçe: Klasë, bashkëpunim, menaxhim, orë mësimore, sfidë,

PARANDALIMI DHE TRAJTIMI I BRAKTISJES NË SHKOLLAT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Edona Jashari, Gresa Zeka, Arbenita Ejupi & Fortuna Zeka, *Fakulteti i Edukimit, Prishtinë, Kosovë*

Braktisja e shkollave nga nxënësit është fenomen shqetësues dhe mjaft kompleks në mbarë botën. Sipas statistikave të MASHTI, edhe në Kosovë, numri i nxënësve që po braktisin shkollën po vazhdon të rritet. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi ishte të kuptojmë se si adresohet çështja e braktisjes së shkollës në politikat arsimore në Kosovë dhe cilat janë përgjegjësitë dhe sfidat që hasin akterët kryesorë në procesin e parandalimit dhe reduktimit të braktisjes së shkollave nga nxënësit e arsimit parauniversitar. Studimi zbatoi qasjen hulumtuese kualitative, ndërsa mostra ishte e qëllimshme duke përfshirë akterët kryesorë që kanë njohuri dhe e zbatojnë këtë proces: dy zyrtarë të MASHTI, dy zyrtarë të DKA-së dhe dy drejtorë shkolle. Si instrument për mbledhjen e të dhënave janë përdorur gjithsej gjashtë intervista gjysmë të strukturuar me këta akterë.

Rezultatet tregojnë se çështja e nxënësve që braktisin shkollën është definuar relativisht qartë në politikat arsimore. Niveli qëndror mbështet nivelin komunal që ata t'i bëjnë planet e veprimit kundër braktisjes, si dhe ju ofron udhëzime praktike për funksionimin e këtyre planeve, kryesisht përmes doracakëve. Vlerësohet roli i organeve të ndërmjetësimit të braktisjes që ekziston në shkolla. Ndërsa, disa nga sfidat e paraqitura janë: mungesa e raportimit të rregullt dhe cilësor nga shkollat, mungesa e kuadrit mbështetës në shkolla, mungesa e bashkëpunimit me prindër, dhe nevoja për të krijuar fondet dhe funksionimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit. Rekomandohet që të fuqizohet tutje bashkëpunimi në mes të gjitha niveleve, sidomos sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të këtij procesi si dhe ofrimit të trajnimeve profesionale që do t'iu mundësonin drejtorëve të njihen më mirë mbi strategjitë e ndërhyrjes lidhur me parandalimin dhe trajtimin e braktisjes së shkollës. Po ashtu, është e nevojshme të shtohet numri i kuadrit mbështetës në shkollë.

Fjalët kyçe: braktisja e shkollës, nxënësit, arsimit parauniversitar.

ZHVILLIMI DHE INTEGRIMI I PARTNERITETEVE STRATEGJIKE NDËRMJET INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE SEKTORIT PRIVAT NË KOSOVË: NJË VËSHTRIM NË POTENCIALIN PËR INOVACION NË ARSIM

Vjollca Llazani Ameti, *ShFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë, Kosovë*

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, partneritetet ndërmjet sektorit publik dhe atij privat po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të adresuar nevojat dinamike të arsimit dhe për të nxitur inovacionin. Ky studim synon të hulumtojë ndikimin dhe potencialin e partneriteteve strategjike mes institucioneve arsimore dhe sektorit privat në Kosovë, me qëllim të nxitjes së inovacionit arsimor. Përmes një metodologjie që përfshin anketimin e pjesëmarrësve, duke përfshirë udhëheqësit e shkollave, mësuesit, nxënësit prindërit dhe përfaqësuesit e biznesit përmes një mostre të rastësishme dhe duke përdorur Google Forms, ky hulumtim kërkon të identifikojë sfidat dhe mundësitë që lindin nga këto partneritete. Veçanërisht do të theksohet analiza e rasteve studimore të suksesshme për të identifikuar praktikatat optimale që mund të aplikohen gjerësisht brenda sistemit arsimor të Kosovës. Rezultatet japin një vlerësim të detajuar të efektivitetit të partneriteteve strategjike për përmirësimin e cilësisë arsimore dhe sugjerojnë politika dhe iniciativa të reja për të nxitur një bashkëpunim të frytshëm ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Kështu, studimi synon të nxjerrë në pah rëndësinë kryesore të bashkëpunimit për sfidat e arsimit modern dhe të promovojë një mjedis inovativ që përgjigjet ndaj nevojave të nxënësve dhe të shoqërisë në tërësi.

Fjalët kyçe: partneritetet strategjike, inovacioni në arsim, sektori privat, cilësia e arsimit, përmirësimi i cilësisë së arsimit.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË MOSZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL

Arditë Sadiku, SHFMU “Gjon Serreci”, Ferizaj, Kosovë

Vargu i reformave që u ndërmorë ndër vite pas lufës në Kosovë, mundësoi dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor. Mungesa e bashkëpunimit dhe vetëdijësimit të shoqërisë për arsimim, po prekin një shtresë tejet të ndjeshme të shoqërisë sonë, personat me aftësi të veçanta. Integrimi i pamjaftueshëm i tyre më parë në procesin mësimor, i dha një mundësi formimit të Planit Individual Arsimor, i cili fatkeqësisht nuk po tregon zbatueshmëri të lartë. Duke identifikuar dhe përmirësuar shërbimet për këta nxënës, PIA kontribuon në sigurimin e një arsimi të barabartë për të gjithë. Ndaj, qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojë dhe të analizojë faktorët që kontribuojnë në moszbatimin e Planit Individual Arsimor në institucionet shkollore të komunës së Ferizaj-it. Përmes identifikimit dhe analizës së këtyre faktorëve, hulumtimi synon të ofrojë një kuptim më të thellë dhe një bazë për rekomandime, për të përmirësuar zbatimin e PIA-së, duke adresuar sfidat dhe mundësitë që paraqiten. Modeli i hulumtimit është përfaqësues (prerjes tërthore). Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është një kombinim i metodave kualitative dhe kuantitative për të kuptuar faktorët që ndikojnë në moszbatimin e Planit Individual Arsimor në institucionet shkollore të Kosovës. Teknika e përdorur është anketa me instrument pyetësorin e strukturuar. Përmbajtja e instrumentit është e përqendruar mbi përvojën, praktikën, perceptimet dhe qëndrimet e mësimitdhënësve lidhur me faktorët që ndikojnë në moszbatimin e PIA-së. Mostra e hulumtimit përfshin 140 mësimitdhënës të ciklit fillor. Të dhënat janë përpunuar dhe analizuar me programin SPSS. Rezultatet kanë treguar që mësimitdhënësit janë të gatshëm të punojnë me PIA dhe besojnë që kjo do rezultonte në ngritjen e suksesit tek nxënësit. Në bazë të rezultateve në shumë institucione shkollore mungojnë politika dhe udhëzime të qarta për zbatimin e PIA-së. Në bazë të përgjigjeve të pedagogëve dhe psikologëve, mungesa e trajnimeve dhe asistencës profesionale është një pengesë për moszbatimin, institucionet shkollore janë të kufizuara nga një mungesë e burimeve financiare dhe materiale për tëmbështetur zbatimin e PIA, poashtu prindërit dhe komuniteti lokal tregojnë një mungesë të vetëdijësimit dhe bashkëpunimit për rëndësinë e përfshirjes së nxënësve me aftësi të veçanta në arsim.

Fjalët kyçe: Edukimi gjithëpërfshirës; Gjithëpërfshirja; Plani Individual Arsimor.

PRAKTIKAT E MIRA TË IMPLEMETIMIT TË KURRIKULËS

Ali Nimani

Implementimi i një kurrikule të bazuar në kompetenca ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e arsimit duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe thjeshtësimit të informacionit. Disa shembuj: Përdorimi i rëndësisë së kontekstit: Kurrikula e bazuar në kompetenca përqendrohet në situata reale, skenarë të rëndësishme ose sfida të cilat nxënësit mund të përballen në karrierën e tyre të ardhshme dhe duke bërë orientimin e planë programeve arsimore nga aspekti shtetëror ose kombëtar ? Analiza dhe planifikimi dhe identifikimi i çështjeve kryesore në sistemin arsimor dhe hartimi i planeve dhe strategjive për t'i adresuar ato. Integrimi i teknologjisë: Përdorimi i teknologjisë moderne mund të ndihmojë në implementimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca duke lejuar përvojë dhe praktika më efektive të mësimit. Mësimi bazuar në projekte: Kërkimi i zgjidhjeve për probleme reale ose projekte komplekse është një mënyrë efektive për të zhvilluar kompetencat e nxënësve në një kontekst praktik, si për shembull kabinetet, ambientet e jashtme etj . Vlerësimi i bazuar në performancë: Për të vlerësuar nëse nxënësit kanë arritur kompetencat e nevojshme, mund të përdoret vlerësimi i bazuar në performancë, duke përfshirë portfolio, njohurit me shkrim, njohurit në të shprehure si dhe praktike ose projekte të mëdha. Si dhe vlerësimi për shkallë nga shkolla si dhe nga Ministria e Arsimit dhe DKA-ja.

Fjalët kyçe: Mësimi, Kurrikula, Arsim.

CONFERENCE BOOK



KOSOVA INTERNATIONAL
CONFERENCE ON EDUCATIONAL
RESEARCH

Katalogim në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.02(062)

Successful implementation of innovative classroom approaches and effective institutional management : Conference Book : Kosovo International Conference on Educational Research KICER 2024 / prepared by Faculty of Education, University of Prishtina. - Prishtinë : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" : Fakulteti i Edukimit, 2024. - 103 f. ; 26 cm.

Teksti paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

ISBN 978-9951-00-360-5